



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Klima e Biznesit në Kosovë TM3 - 2023



Prishtinë, 2023



INDIKATOR MATËS I TENDENCËS NË BIZNES

Tre mujori i tretë i vitit 2023



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE





Të nderuar miq dhe kolegë

Iniciativa për rifillimin e publikimit të raportit “Monitorimi i bizneseve në Kosovë” nga Oda Ekonomike e Kosovës, është një hap i rëndësishëm që siguron informacione të sakta për bizneset në Kosovë. Oda Ekonomike e Kosovës gjatë këtij studimi synon që përveç informimit të përceptimit të komunitetit të biznesit të trendëve

të bizneseve të Kosovës, gjithashtu të promovoj vlerat e biznesit të Kosovës dhe të kontribuoj në përfrimin e tyre me vlerat Evropiane. Oda Ekonomike e Kosovës gjatë aktivitetit të saj ka pasur për qëllim të rrisë nivelin gjeneral të ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje në vlerën e sipërmarrësisë që Kosova posedon. Në lidhje me këtë, rol të rëndësishëm në krijimin e vlerave të brendshme në Kosovë dhe vendosjen e tyre në tregjet nacionale dhe internacionale e ka komuniteti i biznesit i cili ndikon në ngritjen e mirëqenies së ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi. Prandaj, për ngritjen e imazhit të shtetit tonë dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj kah format e ndryshme të partneritetit. Ky publikim para se gjithash do t’u shpërndahe të gjitha kompanive që kanë participuar në studim, të gjitha institucionet shtetërore, organizatat e biznesit, zyrat diplomatike, organizatat e donatorëve dhe të gjitha grupet e interesit të cilat në mënyrë direkte dhe indirekte influencohen nga promovimi i aktiviteteve të ekonomisë së Kosovës. Gjithashtu, ky studim do t’u shpërndahe atyre që kanë ndihmuar në ngritjen e imazhit të Kosovës dhe vlerave të tyre në Kosovë dhe jashtë vendit.

Që nga 2023 ky studim do të ketë vend të rregullt në baza tre mujore.

Me respekt

Lulzim Rafuna

Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës





Përmbajtja

Përmbledhje	4
1. Hyrja dhe metodologjia	7
2. Rezultatet e përgjithshme	10
2.1. Treguesi i klimës së biznesit.....	15
2.2. Indikator i besueshmërisë (konfidencës).....	16
2.3. Pamja e përgjithshme sektoriale.....	17
3. Analiza Sektoriale	21
3.1. Sektori i prodhimit.....	21
3.2. Sektori i ndërtimtarisë	23
3.3. Sektori i tregtisë me pakicë	25
3.4. Sektori i tregtisë me shumicë	27
3.5. Sektori i shërbimeve.....	29
4. Barrierat për zhvillim sectorial.....	31
4.1. Barrierat për zhvillim të biznesit në Kosovë	31
5. Sfidat e ndërmarrjeve lidhur me rekrutimin e fuqisë punëtore	33
5.1. Situata aktuale e bashkëpunimit në mes kompanive dhe institucioneve arsimore.....	33
5.2. Sfidat e tregut të punës në vitin e ardhshëm	36
6. Deklarata e Përgjithshme dhe konkluzione.....	43



Përmbledhje

Studimi i klimës së biznesit në Kosovë ka shërbyer si një mjet thelbësor për të vlerësuar dhe monitoruar mjedisin ekonomik në vend. Oda Ekonomike e Kosovës ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm me implementimin e këtij studimi, duke krijuar kështu një infrastrukturë të fuqishme të informacionit për biznesin dhe investitorët.

Anketat e klimës së biznesit ofrojnë një pasqyrë të plotë të kushteve të biznesit, duke identifikuar sfidat, problemet, dhe ndryshimet e rëndësishme në ambientin ekonomik. Këto informacione janë të rëndësishme për udhëheqjen e bizneseve dhe politikëbërësit, duke u mundësuar atyre të marrin vendime të informuara. Për investitorët e huaj, këto të dhëna ofrojnë një vlerësim të potencialit dhe rreziqeve të investimeve në Kosovë.

Monitorimi i analizës së bizneseve është një burim i rëndësishëm i informacionit për aktivitetin ekonomik të një shteti, duke ndihmuar autoritetet të identifikojnë faktorët që ndikojnë në konkurrencën dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Ky lloj monitorimi përdoret gjerësisht në shtete anëtare të Bashkimit Europian dhe në ekonomitë e zhvilluara në nivel global.

Implementimi i studimit të klimës së biznesit nga Oda Ekonomike e Kosovës paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të ambientit ekonomik dhe promovimit të investimeve në vend. Kjo analizë siguron që politikat dhe vendimet ekonomike të marrë në Kosovë janë të mbështetura në të dhëna të sakta dhe të verifikuara.

Anketat e hulumtimit që fokusohen në sektorë të ndryshëm si prodhimi, ndërtimi, shërbimet, tregtia me pakicë dhe tregtia me shumicë ofrojnë një perspektivë të gjerë të situatës ekonomike në Kosovë. Këto sektore janë thelbësore për ekonominë dhe aktivitetin tregtar të vendit.

Monitorimi i analizës së bizneseve përmes mbledhjes së informacioneve nga menaxherët e bizneseve paraqet një metodë të rëndësishme për të vlerësuar situatën ekonomike dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen. Informacionet kualitative, duke përfshirë vlerësimet dhe



opinionet e menaxherëve, ofrojnë një perspektivë të shpejtë dhe të lehtësuar për identifikimin e tendencave dhe zhvillimeve në industrinë dhe sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

Klima e biznesit në Kosovë nuk shihet si e favorshme dhe pritjet janë që kjo gjendje të vazhdojë edhe gjatë dy tremujoreve të ardhshëm.

Situata e përgjithshme e biznesit në Kosovë vlerësohet si e pa e kënaqshme, duke treguar se vetëm 13% e kompanive konsiderojnë situatën e tyre të biznesit si të mirë, 24.40% si të kënaqshme, ndërsa 62.60% e shohin situatën e tyre si jo të kënaqshme. Kjo tregon se bizneset në Kosovë përballen me një nivel brishtësie në aktivitetin e tyre gjatë këtij tremujori.

Ky vlerësim i bizneseve vjen si pasojë e mosreflektimit në stabilitetin ekonomik, mos rritjen e aktivitetit prodhues, mos krijimin e mundësive të reja biznesi, mos investimeve kapitale në nivel lokal dhe qendror, si dhe mungesës së masave dhe politikave për të përmirësuar klimën e biznesit në vend. Këtë vlerësim e bëjnë vetë kompanitë, dhe ai reflekton perceptimin e tyre në një moment të caktuar.

Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se situata e biznesit mund të ndryshojë shpejt në kontekstin e ndryshimeve të ekonomisë, politikave, dhe faktorëve të tjerë të jashtëm.

Pritjet e biznesit për tremujorin e ardhshëm tregojnë një pritje të lehtë për punësim në Kosovë, me rreth 11.20% të bizneseve që parashikojnë rritjen e numrit të punëtorëve. Kjo shenjë e qartë e mosbesimit në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe nevojën për forca punëtore shtesë vjen si rezultat i mosbesimit të bizneseve për rekrutimin e stafit në masë, duke parashikuar lëvizje të shumta nga janari i vitit 2024. Në anën tjetër, vetëm 3.20% e ndërmarrjeve presin zvogëlimin e numrit të të punësuarve, një shifër dy herë më e lartë se në tremujorin e kaluar, ndërsa 85.60% e tyre presin që numri i të punësuarve të mbetet pothuajse i pandryshuar.

Rritja e numrit të bizneseve që thksojnë se kanë aktivitet biznesor të pa favorshëm dhe prosin që të vazhdojë, është një lajm të jo i mirë për zhvillimin ekonomik në Kosovë.



Megjithatë, është shqetësuese të dëgjohet se në periudhën gjashtëmujore bizneset presin një zhvillim të jo të favorshëm të aktivitetit të tyre. Rreth 18.20% e bizneseve parashikojnë një përkeqësim të aktivitetit apo zhvillim të pafavorshëm, ndërsa 66.60% presin që gjendja e tyre biznesore të mbetet e njëjtë, edhe pse të cilën e konsiderojnë si jo të favorshme. Kjo tregon një shenjë të qartë të rënjes së optimizmit dhe besimit në rritjen e ekonomisë dhe performancën e biznesit. Pritja e kësaj natyre shpesh vjen si rezultat i faktorëve të ndryshëm si inflacioni, mungesa e cash flow, sezoni i ndërtimit që mund të sjellë rënie të aktivitetit tregtar, mungesa e investimeve kapitale, rënia e eksportit, dhe rënia e aktivitetit tek sektori i ndërtimtarisë.

Klima e biznesit në Kosovë në përgjithësi paraqitet si jo e favorshme tek shumë biznese, dhe pritjet e biznesit tregojnë një nivel të ulët të optimizmit. Mosoptimizmi i shprehur nga bizneset bazohet në shpresat dhe pritjet për faktorë të ndryshëm që mund të ndikojnë në aktivitetin tregtar dhe performancën e biznesit. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se pritjet janë të kushtëzuara nga kushtet aktuale dhe mund të ndryshojnë nëse situata ndryshon. Në përgjithësi, ky nivel i pritjeve të bizneseve tregon se klima e biznesit në këtë tremujor dhe në dy tremujorët e ardhshëm do të jetë sfiduese për sektorin privat në Kosovë.





1. Hyrja dhe metodologjia

Oda Ekonomike e Kosovës ka ndërmarrë një iniciativë të rëndësishme duke kryer monitorimin e analizës së bizneseve për tremujorin e tretë të vitit 2023. Kjo përpjekje ka si qëllim vlerësimin e perceptimit të biznesit në lidhje me klimën ekonomike në Kosovë. Studimi është i përqendruar në sigurimin e një burimi të rëndësishëm të informacionit, duke sjellë një ndërthurje të të dhënave kualitative dhe sasiore, për të ndihmuar aktorët e biznesit, politikëbërësit dhe investitorët e huaj në marrjen e vendimeve të informuara.

Ky lloj monitorimi dhe analize praktikohet me sukses në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe në vendet e zhvilluara ekonomisht, ku ka treguar rëndësinë dhe efektivitetin e tij në procesin e planifikimit dhe zhvillimit ekonomik. Me këtë studim, Oda Ekonomike e Kosovës synon të promovojë një kulturë të informacionit dhe transparencës mbi klimën e biznesit në sektorin e biznesit, duke siguruar një bazë të qëndrueshme të informacionit për marrjen e vendimeve dhe formulimin e politikave ekonomike në vend.

Hulumtimi i monitorimit të analizës së bizneseve në Kosovë zhvillohet me rregullsi tremujore, duke siguruar detaje të hollësishme mbi perceptimin e kompanive në lidhje me situatën aktuale dhe pritshmëritë e tyre. Përfaqësueshmëria e muestrës është arritur duke intervistuar 500 kompani të zgjedhura nga sektorët kryesorë të ekonomisë, duke përfshirë prodhimin, ndërtimin, tregtinë me shumicë dhe me pakicë, si dhe sektorët e shërbimeve.

Anketimi ka një ndërthurje të pyetjeve që lejojnë kompanitë të shprehin vlerësimin e tyre në lidhje me zhvillimet e fundit, situatën aktuale dhe pritshmëritë për periudhën e ardhshme. Për të siguruar përfaqësueshmëri dhe analizë të saktë, struktura e mostrës është përcaktuar duke përdorur një klasifikim sipas madhësisë së kompanive dhe sektoreve të tyre të veçantë dhe regjionit të tyre.

Procesi i anketimit dhe monitorimit të biznesit është i koordinuar dhe drejtuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, duke garantuar organizimin dhe interpretimin e të dhënave në mënyrë



cilësore dhe të besueshme. Të dhënat e mbledhura janë trajtuar nga Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Komunikim Strategjik në Oda Ekonomike e Kosovës, përgjegjës për sigurimin e informacionit të nevojshëm për aktorët ekonomikë dhe politikëbërësit. Ky proces i analizës së bizneseve paraqet një përpjekje të rëndësishme për të siguruar një pasqyrë të qartë dhe të shpjegueshme të klimës së biznesit në Kosovë. Për më tepër, ky studim ofron një bazë të rëndësishme të informacionit për aktorët e ndryshëm që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Tabela 1 përmban pyetësorët e kompletuar në bazë të sektorëve dhe mostrës. Në tabelë, madhësia e klasave është përcaktuar sipas klasifikimeve standarde të përdorura për të ndarë kompanitë në kategori të ndryshme bazuar në numrin e punëtorëve të tyre. Klasifikimet standarde janë si vijon:

- ✓ Kompanitë me 1-9 punëtorë konsiderohen si mikro ndërmarrje.
- ✓ Kompanitë me 10-49 punëtorë konsiderohen si kompani të vogla.
- ✓ Kompanitë me 50-249 punëtorë konsiderohen si kompani të mesme.
- ✓ Kompanitë me mbi 250 punëtorë konsiderohen si kompani të mëdha.

Këto klasifikime ndihmojnë në vlerësimin dhe analizën e ndryshimeve në situatën e biznesit nëpërmjet grupimit të tyre sipas madhësisë së tyre në punëtorë. Nëpërmjet kësaj segmentimi, është e mundur të vlerësohet ndikimi dhe pritjet e bizneseve në varësi të madhësisë së tyre.

Tabela 1: Një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në sektorë dhe në madhësi të kompanive

Sektorët	Pyetësorët	%	Micro (0-9)	Të Vogëla (10 - 49)	Të Mesme (50 - 249)	Të Mëdha (>250)
Prodhim	112	22.40%	48	45	18	1
Shërbimet	118	23.60%	80	29	8	1
Ndërtim	72	14.40%	27	31	11	3
Tregti me pakicë	112	22.40%	54	41	15	2
Tregti me shumicë	86	17.20%	29	43	13	1
Gjithsej	500	100	238	189	65	8
Përqindja nga madhësia			47.60%	37.80%	13%	1.60%



Tabela 2 tregon shpërndarjen e mostrës sipas rajoneve të bazuar në numrin e bizneseve aktive në ATK. Kjo shpërndarje është përcaktuar në bazë të përqindjes së bizneseve aktive në çdo rajon të ATK-së. Sipas të dhënave që keni dhënë, tabela tregon se në mostrën e përdorur, përqindjet e bizneseve sipas rajoneve janë si: Ferizaj: 13%, Gjakovë: 10%, Gjilan: 9%, Mitrovicë: 9%, Pejë: 10%, Prishtinë: 33%, Prizren: 16%.

Ky përfaqëson përqindjen e bizneseve të përfshira në mostrë nga çdo rajon i ATK-së, duke marrë parasysh numrin e bizneseve aktive në secilin rajon.

Tabela 2: Një përmbledhje e pyetësorëve duke u bazuar në sektor dhe në madhësi të kompanive


Sektorët	Pyetësorët	%	Micro (0–9)	Të Vogëla (10 – 49)	Të Mesme (50 - 249)	Të Mëdha (>250)
Prishtinë	165	33%	53	83	27	2
Mitrovicë	45	9%	32	8	3	2
Pejë	50	10%	35	10	3	2
Prizren	80	16%	16	41	22	1
Ferizaj	65	13%	43	15	6	0
Gjilan	45	9%	18	23	4	0
Gjakovë	50	10%	41	9	0	1
Gjithsej	500	100	238	189	65	8
Përqindja nga madhësia			47.60%	37.80%	13%	1.60%

2. Rezultatet e përgjithshme

Sipas rezultateve të tremujorit të tretë të këtij viti, analiza profesionale bën të ditur se vetëm një përqindje prej 13% të kompanive vlerësojnë situatën e tyre të biznesit si të mirë, ndërsa një shifër prej 24% e konsiderojnë atë të kënaqshme. Në të kundërt, shumica prej 63% e kompanive të intervistuar shfaqën pakënaqësi në lidhje me situatën e tyre të biznesit. Duke bërë një vështrim të përgjithshëm, mund të konkludojmë se situata aktuale e përgjithshme e biznesit për kompanitë në Kosovë konsiderohet jo e favorshme.

Nëse e krahasojmë me tremujoret e këtij viti, vërehet se çdo tremujor ka sjellë një rritje të mjedisit të pakënaqshëm për të bërë biznes. Figura 1, e cila shfaq vlerësimin e situatës së biznesit në përqindje për kompanitë, që përcakton qartë se vetëm një pjesë e vogël e tyre është e kënaqur me situatën aktuale të të bërit biznes. Kjo tendencë përgjithësisht tregon një drejtim të një sfide të vazhdueshme për sektorin e biznesit në Kosovë gjatë këtij viti.

Figura 1: Situata e biznesit është vlerësuar si (% e kompanive)



Në analizën e aspektit tjetër të vlerësimit të klimës së biznesit, fokusi është te balanca, një parametër i rëndësishëm që përcakton diferencën midis vlerësimeve pozitive dhe negative të situatës së biznesit. Në këtë kontekst, rezultatet tregojnë një trend mjaft negativ për këtë tremujor. Në krahasim me situatën e mëparshme të biznesit (TM2 2023), vërehet një rënje prej




53 pikë për qind (p.p.), një ndryshim i ndjeshëm që tregon përkeqësim të dukshëm të klimës aktuale të biznesit në Kosovë.

Kur e krahasojmë situatën e këtij tremujori (TM3 2023) me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (TM3 2022), vërehet gjithashtu një përkeqësim i ndjeshëm me një rënje prej 14 p.p. Kjo sugjeron se gjendja aktuale e klimës së biznesit është përkeqësuar në krahasim me të njëjtën kohë në vitin e kaluar. Është e rëndësishme të theksohet se kjo rënje vjen pasi tremujori e parë dhe i dytë i vitit 2023 kishin një balancë pozitive në vlerësimin e situatës së klimës së biznesit.

Ndërsa, Figura 2, e cila paraqet vlerësimin e gjendjes aktuale në formën e balancës, shpalos qartë këtë tendencë negative. Një balancë e ulët tregon se shumica e kompanive të anketuara kanë shprehur një perceptim negativ të situatës së biznesit. Kjo gjendje aktuale e klimës së biznesit bën të qartë se këtë tremujor është karakterizuar si një sfidë e rëndë për sektorin e biznesit në Kosovë.

Figura 2: Vlerësimi i gjendjes aktuale: Balanca



Tremujori i tretë i këtij viti shënon një zvogëlim të pritjeve për punësim, duke pasuar një trend negativ nga dy tremujoret e kaluar të këtij viti. Rreth 11% e kompanive pjesëmarrëse në këtë studim shprehen se kanë qëllim të rrisin numrin e punëtorëve në periudhën e ardhshme. Megjithatë, ky parashikim pozitiv është i kufizuar në një përqindje relativisht të vogël të bizneseve dhe pritet të ketë një ndikim të kufizuar në zbutjen e papunësisë në nivel vendi.



Në anën tjetër, shumica prej 86% të bizneseve të anketuara deklarojnë se do të mbajnë numrin e njëjtë të punëtorëve, shfaqur kështu një nivel stabiliteti në këtë aspekt. Vetëm 3% e ndërmarrjeve presin të zvogëlojnë numrin e të punësuarve, një shifër që shënon një rënie në krahasim me 22% që ishte në tremujorin e kaluar.

Ky rezultat është rezultat i një sërë faktorësh me të cilët sektori privat dhe vendi ynë po ballafaqohen aktualisht. Ndikimet e ndryshme, përfshirë kushtet ekonomike globale, politikat vendore dhe zhvillimet e brendshme të sektorit, kanë ndikuar në pritjet dhe vendimet e kompanive në lidhje me fuqin e punës.

Figura 3: Pritjet e punësimit për tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)





Figura 4 paraqet një zhvillim interesant gjatë këtij tremujori, duke treguar një rritje të konsiderueshme në balancën e pritjeve për punësim. Krahasimi me tremujorin e mëparshëm tregon një rritje prej 5 p.p. (pikë për qind), një shifër që vërteton një tendencë pozitive, megjithëse jo shumë dominuese.

Kjo rritje vjen pas një periudhe relativisht të vështirë, ku pritjet për punësim ishin të vogla. Tremujori i kaluar kishte një nivel pritjesh më të ulët, ndaj edhe rritja e treguesit të Balancës në këtë tremujor shihet si një ndryshim pozitiv, edhe pse të vogël.



E rëndësishme është që kjo rritje e pritjeve për punësim lidhet me faktin se një numër më i madh i kompanive në këtë tremujor deklaruan që do të ruajnë numrin aktual të punësuarve. Kjo është një shenjë e qartë stabiliteti dhe kujdesit që shprehin bizneset në lidhje me fuqinë e punëtore. Në të njëjtën kohë, ka një rritje të përqindjes së kompanive që dëshirojnë vetëm të mbajnë numrin aktual të të punësuarve, duke treguar një qëndrim më të kujdesshëm ndaj rritjes së ekuilibrit në strukturën e tyre. Në kontekstin tjetër, është vërejtur një rënje e konsiderueshme në përqindjen e kompanive që shprehen të interesuara për të rritur numrin e të punësuarve në të ardhmen.

Figura 4: Pritjet për punësim: Balanca



Komuniteti i biznesit në Kosovë shpreh një pikëpamje të kujdesshme dhe skeptike në lidhje me pritjet për zhvillimin e aktivitetit të tyre gjatë periudhës gjashtëmujore. Vetëm 11% e bizneseve të anketuara shprehin pritje pozitive për përmirësimin e situatës së biznesit, ndërsa një pjesë shumicë prej 71% pritet që gjendja të mbetet e njëjtë. Në anën tjetër, 18% e kompanive parashikojnë një përkeqësim të situatës biznesore.


Këto pritje të kufizuara për përmirësim dhe tendenca e një numri të konsiderueshëm të kompanive që parashikojnë një përkeqësim në aktivitetin e tyre shënojnë një nivel të ulët të optimizmit në komunitetin e biznesit. Ky skenar i parashikimit të një periudhe të vështirë vjen në



kontekstin e një rënie të ndjeshme të pritjeve krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, duke shënuar një rënje prej 2 p.p.

Për periudhën e ardhshme, pritjet kanë pësuar një zvogëlim të konsiderueshëm, duke treguar një rënje prej 22 p.p. krahasuar me pritjet e njëjtë të tremujorit të kaluar. Kjo ulje e pritjeve për 6 muajt e ardhshëm ndërmjet dy tremujoreve tregon një ndjenjë më të thellë të pasigurisë dhe kujdesit në lidhje me klimën e biznesit në Kosovë. Bizneset shfaqin një nivel të lartë të kujdesit për zhvillimet e mundshme dhe tregojnë një reflektim të vështirësive të pritshme në horizontin afatshkurtër.

Figura 5: Pritjet për gjendjen e biznesit në 6 muajt e ardhshëm (% e kompanive)




Gjetjet e paraqitura theksojnë një tendencë të qartë në rënie të pritjeve, e cila gjithashtu reflektohet në balancën e situatës së biznesit. Analiza e detajuar tregon se pritjet për situatën e biznesit në 6 muajt e ardhshëm shënojnë një zvogëlim të ndjeshëm, duke parashikuar një përkeqësim të konsiderueshëm. Në bazë të këtyre rezultateve, pritet që balanca të jetë -1 p.p., e cila interpretohet si një indikacion i rënies së pritjeve për të përmirësuar gjendjen e bizneseve në 6 muajt e ardhshëm.

Ky trend negativ i pritjeve tregon një nivel të lartë të kujdesit dhe pasigurisë në komunitetin e biznesit në lidhje me zhvillimet e ardhshme. Rënia e pritjeve në një periudhë të afërt sugjeron një



klime të vështirë dhe sfiduese për bizneset në Kosovë, duke ndikuar në qëndrueshmërinë dhe perspektivën afatshkurtër të sektorit privat. Pritjet e këtilla të rënies në balancën e situatës së biznesit shërbejnë si alarmin e një mjedisi ekonomik të ndjeshëm dhe të pasigurt.

Figura 6: Pritjet për 6 muajt e ardhshëm - Balanca



2.1. Treguesi i klimës së biznesit


Treguesi i klimës së biznesit është një mjete e rëndësishme për të vlerësuar gjendjen e përgjithshme ekonomike të vendit. Ky tregues, i cili përdor një mesatare aritmetike midis situatës aktuale dhe pritjeve për të ardhmen, paraqet një përfundim të nivelit të vlerësimit të situatës ekonomike në një periudhë gjashtëmuajore.

Në tremujorin aktual, TM3 2023, treguesi i klimës së biznesit shënon një rënje prej rreth 20 p.p. krahasuar me periudhën e mëparshme. Kjo indikon se klima e biznesit në Kosovë ka filluar të krijohet në një mënyrë jo të favorshme dhe jo të qëndrueshme për ndërmarrjet vendore.

Situata e pafavorshme e treguesit të klimës së biznesit tregon për një zhvillim negativ në kontekstin ekonomik të vendit. Kjo ngjarje e fundit tregon se ndërmarrjet po përballen me kushte të vështira dhe sfiduese, duke pasqyruar një mjedis të pasigurt dhe jo të përshtatshëm për

operimin e tyre në Kosovë. Ky rezultat sugjeron nevojën për vëmendje dhe masa të përshtatshme nga aktorët ekonomikë dhe politikëbërësit për të përmirësuar kushtet dhe klimën e biznesit në vend.

Figura 7: Klima e biznesit në Kosovë



2.2. Indikatori i besueshmërisë (konfidencës)


Treguesi i klimës së biznesit përqëndrohet në vlerësimin e situatës së fitimit të ndërmarrjeve, duke përfshirë aspektet aktuale dhe pritjet për të ardhmen. Megjithatë, indeksi i konfidencës, njohur për rëndësinë e tij në vlerësimin e aktivitetit të biznesit, jep një perspektivë më të hollësishme mbi shkallën e besimit, pavarësisht nga të ardhurat e konkreta që mund të realizon një ndërmarrje. Ky tregues i konfidencës ka një histori të gjatë përdorimi në analizën ekonomike të Komisionit Evropian dhe është i përdorur gjerësisht për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2023, në tremujorin e dytë, treguesi i konfidencës ka regjistruar një zvogëlim të ndjeshëm të shkallës së konfidencës në krahasim me periudhën e mëparshme, duke përfshirë një rënje prej 32 p.p. në tremujorin e tretë të vitit 2023. Kjo tendencë rënëse ka nisur në tremujorin e dytë të vitit 2023, duke shënuar një humbje të shkallës së konsiderueshme të besimit prej 47 p.p. në

krahasim me tremujorin e parë të vitit 2023. Ndërkaq, duke krahasuar tremujorin e tretë të vitit 2023 me të njëjtën periudhë të vitit 2022, vërehet gjithashtu një rënie e treguesit të konfidencës prej 17 p.p.

Këto ndryshime në treguesin e konfidencës paraqesin një nivel të lartë të rënies së optimizmit dhe besimit në aktivitetin e biznesit. Edhe pse ende shfaq një nivel të caktuar të besimit, kjo humbje e besueshmërisë në përmirësimin e gjendjes ekonomike tregon se perspektivat pozitive për zhvillimin e biznesit kanë pësuar një zvogëlim të konsiderueshëm për të ardhmen.

Figura 8: Konfidenca e bizneseve në Kosovë



2.3. Pamja e përgjithshme sektoriale


Figura 9 është një ilustrim grafik që pasqyron përmasat e situatës aktuale të biznesit në pesë sektorët kryesorë të përfshirë në këtë hulumtim. Vlerësimi i situatës së biznesit për secilin sektor është bërë duke përdorur tri shkallë të nivelit, me të cilën secili subjekt ka vlerësuar gjendjen ekzistuese të tyre.



Bazuar në rezultatet e paraqitura në Figurën 9, të gjithë sektorët e analizuar shprehin një këndvështrim negativ duke vlerësuar situatën e tyre të biznesit si të jo favorshme. Shkalla mesatare e vlerësimit të situatës së biznesit për të gjithë sektorët arrin rreth 62% si të jo favorshme, theksuar kështu një ndjesi të përgjithshme të pasigurisë dhe sfidës në mjedisin e tyre operacional.

Analiza e të dhënave tregon se të gjitha sektorët janë prekur nga një situatë e pa favorshme, duke dëshmuar ndikimin negativ të krijuar nga kushtet e vështira ekonomike. Figura 9 ofron një panoramë të qartë dhe lidhur me perceptimet aktuale të ndërmarrjeve në këto sektorë dhe konfirmon sfidat e tyre të përbashkëta në periudhën e tanishme.

Figura 9: Vlerësimi i situatës së biznesit (% e kompanive)



Analiza e pritjeve për punësim në tre muajt e ardhshëm shpalos një pamje të qartë të klimës së biznesit në sektorët e ndryshëm. Rezultatet e fituara tregojnë një tendencë të ulët të pritjeve për punësim në të gjitha sektorët, duke sjellë një perspektivë jo shumë premtuese për zhvillimet e




afërta. Ky zbritje e pritjeve ka karakteristikat e një mjedisi të pasigurt dhe një nivel të ulët optimizmi për zgjerimin e kapaciteteve dhe rekrutimin e personelit të ri.

Në kontekstin e parashikimeve të mundshme të levizjes së fuqisë punëtore nga 01 Janari 2024, kompanitë shprehen të kujdesshme në rekrutimin e stafit të ri, shfaqur një ndjenjë të pasigurtë lidhur me mundësitë e rekrutimit. Disa sektorë, nën ndikimin e faktorëve të tilla si rënia e eksportit, mungesa e investimeve kapitale në vend, dhe pengesat e tjera, kanë shprehur nevojën për të përqendruar më shumë në ruajtjen e punëtorëve ekzistues sesa në zgjerimin e kapaciteteve të tyre.

Përtej kësaj, disa kompani, megjithatë në numër të pakët, kanë nisur të eksplorojnë mundësinë e rekrutimit të punëtorëve nga vendet e huaja, një ndryshim që mund të interpretohet si përpjekje për të plotësuar zbrazësitë e mundshme në fuqinë punëtore vendase.

Figura 10 paraqet këtë analizë duke shfaqur këto tendenca nëpërmjet një pamjeje grafike, duke theksuar rëndësinë e këtyre informacioneve për të kuptuar klimën e biznesit dhe perspektivat për tregun e punës në vend.

Figura 10: Pritjet për punësimin për tre muajt e ardhshëm






Analiza për periudhën e ardhshme, e bazuar në pritjet e sektorëve për 6 muajt, shënon një pamje jo optimiste dhe një mungesë besimi të lartë në përmirësimin e gjendjes së biznesit. Rezultatet tregojnë një tendencë drejt një mosbesimi të përgjithshëm, me shumicën e sektorëve që karakterizohen nga një ulje e theksuar e pritjeve për të ardhmen.

Ky mungesë optimizmi dhe pritjet e ulëta në sektorë dëshmojnë për një mjedis të vështirë dhe jo të favorshëm për zhvillimin e biznesit në periudhën e ardhshme. Për shkaqe të ndryshme, të tilla si kushtet ekonomike globale, ndryshimet në kërkesën e tregut, ose faktorët vendas, kompanitë nuk shprehin besim të mjaftueshëm në mundësitë e rritjes dhe përmirësimit të kushteve të tyre ekonomike në të ardhmen e afërt.

Kjo analizë tregon një përshtypje të përgjithshme të pesimizmit dhe vështirësive të pritshme për sektorët e ekonomisë në periudhën e ardhshme, duke theksuar nevojën për strategji dhe masa të kujdesshme për të kapërcyer sfidat e mundshme dhe për të siguruar qëndrueshmëri në aktivitetin e biznesit.

Figura 11: Pritjet për gjendjen e biznesit për 6 muajt e ardhshëm (% e kompanive)





3. Analiza Sektoriale

3.1. Sektori i prodhimit

Sektori i prodhimit në Kosovë vazhdon të përballet me sfida të shumta që kanë krijuar një nivel të ulët të aftësisë konkurruese, duke përfshirë faktorë të brendshëm dhe jashtëm. Pjesëmarrja e këtij sektori në Produktin Vendor Bruto është krahasueshme me disa vende të rajonit, megjithatë, për të arritur një zhvillim më të madh dhe për të krijuar vende të punës të reja, ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.


Në këtë tremujor, sektori i prodhimit ka pësuar një rënje në aktivitetin e tij prodhues, duke vijuar tendencën negative që është shënuar edhe në dy tremujoret e kaluara. Në periudhën Janar – Shtator 2023, ka ndodhur një rënie prej deri në 25% të eksportit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar¹. Kjo ulje në eksport ka kufizuar aktivitetin e sektorit, sidomos për shkak të mungesës së investimeve kapitale në nivel qendror. Vetëm 30% e investimeve kapitale të planifikuara për vitin 2023 janë realizuar deri në këtë moment, gjithashtu mestaren e njëjtë të investimeve e kemi edhe nga niveli local dhe që janë shumë të ulëta.

Ky kontekst ka ndikuar negativisht në shumë biznese prodhuese në vend, duke sjellë ndërprerje të shumta në veprimtarinë e tyre. Renja në eksport dhe mungesa e investimeve janë faktorë që kanë theksuar kërkesën për masa të veçanta përkrahëse për të këtë sektor dhe për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin e tij në periudhën e ardhshme.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës




Figura 12: Prodhimi në 3 muajt fundit (% e kompanive)



Në sektorin e prodhimit, vetëm rreth 18% e kompanive kanë pritje të favorshme për tre muajt e ardhshëm dhe parashikojnë të rrisin linjat e tyre prodhuese. Për një përqindje prej 63%, pritet që nivelin e prodhimit të mbajnë të pandryshuar, ndërsa vetëm 19% kanë deklaruar se presin një rënie të aktivitetit prodhues. Këto rezultate përbëjnë një reflektim të situatës komplekse në të cilën ndodhet sektori i prodhimit në Kosovë, duke pasuar tendencën e një mosbesim të thellë për zhvillimet pozitive në tre muajt e ardhshëm.

Shumë faktorë kontribuojnë në këtë panoramë jo optimiste, përfshirë mungesën e investimeve, rënieën e eksportit, dhe barrierat tjera të brendshme me cilat përballen NVM-të në Kosovë. Në kontekstin e këtyre sfidave, shumica e kompanive shprehin një mosbesim të fuqishëm për të shprehur pritje pozitive për rritjen e linjave prodhuese. Ky mungesë besimi është shqetësues për perspektivën e përgjithshme të sektorit të prodhimit, duke ndikuar negativisht në mundësinë e përmirësimit të performancës së tyre dhe krijimin e më shumë vende pune në këtë sektor. (shih Figurën 13).

Figura 13: Pritjet për prodhim në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



3.2. Sektori i ndërtimtarisë

Sektori i ndërtimit në tre muajin e tretë të vitit 2023 ka vazhduar të përballhet me sfida të mëdha, veçanërisht në fushën e shitjeve të banesave. Ky sektor ka filluar të regjistrojë një rënie të konsiderueshme të shitjeve që ka nisur që nga viti 2022, duke paraqitur një ulje prej 10% në krahasim me vitin 2021². Ky trend negativ vazhdon edhe në vitin 2023, siç vërtetojnë edhe kompanitë e anketuara.


Figura 14 shpalos qartë se sektori i ndërtimit është ndikuar negativisht, me rreth 28% të kompanive të ndërtimit raportuar se situata e biznesit ka mbetur e pandryshuar, ndërsa rreth 49% kanë deklaruar një përkeqësim të shënimshëm të aktivitetit të tyre të biznesit. Vetëm 23% e kompanive kanë raportuar rritje në 3 muajt e fundit. Renja e performancës në këtë sektor është pjesë e një skenari më të gjerë të faktorëve sfidues, përfshirë mungesën e cash flow-it, inflacionin, mosstabilitetin politik, dhe planifikimin e lëvizjes së shumë familjeve pas 1 janarit 2024. Këto

² Agjencia e Statistikave të Kosovës



faktorë kanë krijuar një mjedis të pasigurt dhe kanë bërë që kompanitë në sektorin e ndërtimit të përballen me vështirësi të mëdha. (shih Figurën 14).


Figura 14. Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Për sektorin e ndërtimit, perspektiva për tremujorin e ardhshëm reflekton një klimë të vështirë dhe më pak optimiste. Vetëm 16% e kompanive shprehen se presin një situatë të përmirësuar, ndërsa shumica prej 65% presin që situata të mbetet më ose pak a shumë e njëjtë. Në anën tjetër, 19% e bizneseve presin një renje. Kjo situatë është ndikuar nga faktorë të ndryshëm, përfshirë faktorin stinor, pasi po hyjmë në stinën e dimrit, ku shumë kompani ulin aktivitetin e tyre për shkak të kushteve të vështira.

Rezultatet tregojnë një mosperspektivë shumë optimiste për këtë sektor në të ardhmen e afërt. Niveli i lartë i mosbesimit dhe mospërputhja e shpresave për një përmirësim të situatës ekonomike në tre muajt e ardhshëm shpreh një klimë sfiduese dhe vështirësi të vazhdueshme për kompanitë e ndërtimit. Ky skenar ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitetin e tyre dhe sjellë një perspektivë të zbehtë për këtë sektor në periudhën e ardhshme. (shih Figurën 14).

Figura 15: Pritjet për tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)




3.3. Sektori i tregtisë me pakicë

Në sektorin e tregtisë me pakicë, gati 49% e kompanive kanë njoftuar se aktiviteti i tyre biznesor gjatë tre muajve të fundit ka mbetur i pandryshuar. Një përqindje prej 25% e kompanive kanë shënuar një përmirësim në aktivitetin e tyre, ndërsa 26% e kompanive raportuan një gjendje të përkeqësuar në krahasim me tremujoret e kaluara. Kjo gjendje e pasigurtë është rezultat i shumë faktorëve, duke përfshirë rritjen e çmimeve, inflacionin, mungesën e cash flow-it, etj.

Rezultatet e anketës tregojnë se një pjesë e madhe e kompanive në sektorin e tregtisë me pakicë kanë qëndruar në një situatë relativisht të njëjtë gjatë tre muajve të fundit, duke vlerësuar këtë periudhë si një vazhdimësi të një gjendjeje jo të favorshme, sipas tyre. Një përqindje e caktuar prej 29% e kompanive ka konstatuar një renje në aktivitetin e tyre, ndërsa një pjesë tjetër prej 25% ka deklaruar se kanë shënuar një rritje në këtë tremujor të fundit. (shih figurën 16). Këto rezultate pasqyrojnë një peizazh të ndërlikuar dhe të ndryshueshëm për kompanitë në sektorin e tregtisë me pakicë.



Figura 16: Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit




Sektori i tregtisë me pakicë shfaq një nivel të lartë të optimizmit në lidhje me pritjet për performancën e tyre biznesore në tre muajt e ardhshëm. Rreth 26% e kompanive në këtë sektor presin që aktiviteti i biznesit të përjetojë një rritje në periudhën e ardhshme. Një përqindje prej 69% e kompanive presin që situata të mbetet e pandryshuar, ndërsa vetëm 5% e tyre presin të kenë një rënie në performancën e tyre biznesore.

Ky nivel i optimizmit tregon se shumica e kompanive në sektorin e tregtisë me pakicë kanë një besim të fuqishëm në rritjen e aktivitetit të tyre. Pritjet pozitive lidhen me faktorë si festat e fundvitit dhe ardhja e diasporës në një masë, si dhe rritja e remitencave nga diaspora në tremujorin e ardhshëm. Këto pritje shfaqin besimin se klima do të jetë e favorshme dhe se mund të ketë një rritje në shitje. (shih figurën 17).



Figura 17: Pritjet në lidhje më aktivitetin e biznesit në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)




3.4. Sektori i tregtisë me shumicë

Rezultatet e paraqitura në Figurën 18 evidentojnë se rreth 23% e tregtarëve me shumicë konsiderojnë se zhvillimi i biznesit të tyre gjatë tre muajve të fundit ka qenë në përmirësim. Përgjigjet e kompanive të anketuara në këtë sektor tregojnë se rreth 58% prej tyre raportuan se nuk patën ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe kohore. Megjithatë, 19% e kompanive raportuan një zvogëlim të aktivitetit biznesor gjatë 3 muajve të fundit.

Në analizën e arsyeve të kësaj rënie, kompanitë në këtë sektor theksojnë se një prej shkaqeve kryesore është rritja e çmimeve, inflacioni, mungesa e cash flow-it, rënia e shitjeve nga bizneset e tregtisë me pakicë, rënia e blerjeve nga sektori i hoteleve dhe restoranteve, etj. Kjo tregon se kushtet e tregtisë mund të jenë përfshirë në ndryshimin e performancës së kompanive dhe rënie të aktivitetit biznesor në disa raste. (shih figurën 18).



Figura 18: Zhvillim i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)




Rreth 21% e kompanive që operojnë në sektorin e tregtisë me shumicë shprehin pritjet e tyre për një përmirësim të aktivitetit biznesor. Ky shifër tregon një nivel jo të lartë të optimizmit dhe besimit të kompanitë, duke shfaqur një përmbajtje të moderuar për një zhvillim pozitiv gjatë periudhës së ardhshme. Përqindja më e madhe, 72%, e kompanive nuk parashikojnë ndonjë ndryshim të veçantë në gjendjen e tyre ekonomike, duke qëndruar në një gjendje relativisht e njëjtë. Ndërsa, 7% e respondentëve kanë parashikuar një përkeqësim në aktivitetin e tyre biznesor.

Ky nivel i ulët i optimizmit dhe besimit tek kompanitë tregon se shumica e tyre parashikojnë një klimë pozitive vetëm nëse arrijnë të rrisin shitjet e tyre, duke ndikuar pozitivisht në sektorin e tregtisë me pakicë, i cili mund të përfitojë nga festat e fundvitit, ardhja e diasporës, apo rritja e remitencave. (shih figurën 19)



Figura 19: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)




3.5. Sektori i shërbimeve

Nga rezultatet e hulumtimit të marra nga kompanitë që operojnë në sektorin e tregtisë me shumicë, vetëm 16% e tyre kanë deklaruar se gjendja e biznesit në tre muajt e fundit është përmirësuar. Ky tregues tregon për një përqindje relativisht të vogël të kompanive që deklarojnë një performancë pozitive gjatë kësaj periudhe kohore. Rreth 61% e kompanive raportuan se gjendja e biznesit është e pandryshuar, ndërsa 23% e tyre raportuan një rënie në gjendjen e tyre biznesore. Kjo tregon se edhe këto kompani në këtë sektor janë të prekura nga situata e pa favorshme në vendin tonë.

Përqindja e lartë e kompanive që nuk kanë parë ndonjë ndryshim të rëndësishëm tregon se ka ende sfida dhe vështirësi që duhen adresuar në këtë sektor për të përmirësuar performancën dhe për të arritur një stabilitet më të mirë në të ardhmen. (shih figurën 20)




Figura 20: Situata e biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Sipas rezultateve të hulumtimit, pritjet për tre muajt e ardhshëm në sektorin e tregtisë me shumicë shfaqen të kufizuara dhe jo shumë optimiste. Rreth 74% e kompanive deklaruan se pritjet e tyre për aktivitetin biznesor në tre muajt e ardhshëm do të mbeten të pandryshuara, duke dëshmuar për një stabilitet aktual në nivelin e tyre të veprimtarisë. Në anën tjetër, rreth 20% e bizneseve të anketuara shprehin pritje për një zhvillim të favorshëm ose rritje të aktivitetit biznesor, tregues që përfaqëson një pritje pozitive për periudhën e ardhshme.

Në kontrast, vetëm 14% e kompanive presin një gjendje të ulët apo përkeqësim të aktivitetit biznesor, ndërsa ky përqindje relativisht e ulët tregon një nivel të konsiderueshëm të skepticitetit dhe mosbesimit në performancën e ardhshme të këtij sektori. (shih figurën 21)

Figura 21: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



4. Barrierat për zhvillim sectorial

4.1. Barrierat për zhvillim të biznesit në Kosovë

Nga rezultatet e hulumtimit të Klimës së Biznesit për tremujorin e tretë të vitit 2023, dalin disa barrierat dhe pengesat që kompanitë ballafaqohen me zhvillimin e aktivitetit të tyre. Këto sfida ndikojnë në performancën dhe funksionimin e tyre, duke sjellë ndër të tjera:

- ✓ Mungesa e porosive: Rreth 53% e kompanive raportojnë se përballen me mungesë të porosive, një problem i ndikuar nga shumë faktorë të cilët ndikojnë në të gjitha sektorët e vendit.
- ✓ Mungesa e personelit të kualifikuar: Rreth 70% e kompanive shprehen se ndeshen me vështirësi në përdorimin e personelit të kualifikuar, një aspekt që bën të vështirë për ta përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të ofruara.




- ✓ Mungesa e kapaciteteve teknike: Rreth 32% e kompanive raportojnë për kapacitete teknike të vogla, një kufizim që mund të pengojë inovacionin dhe përmirësimin e proceseve teknologjike.
- ✓ Mungesa e cash flow-it: Rreth 66% e kompanive identifikojnë mungesën e cash flow-it si një pengesë, që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të menaxhuar aktivitetin e tyre biznesor dhe marrëdhëniet me partnerët dhe klientët.
- ✓ Vështirësi në marrjen e kredive: Rreth 31% e kompanive shprehen se hasin vështirësi në marrjen e kredive, një pengesë që mund të frenojë investimet dhe rritjen e tyre.
- ✓ Kamatat e larta: Rreth 41% e kompanive shprehen se kamatat e larta janë një tjetër pengesë që ndikon në shpenzimet e tyre dhe aftësinë për të marrë kredi.
- ✓ Konkurenca jo lojale: Rreth 23% e kompanive ndeshen me konkurrencë të pakonkurruese, një situatë që sjell sfida në përpjekjet e tyre për të rritur performancën dhe mbijetuar në treg.
- ✓ Ndërprerjet e energjisë elektrike: Rreth 28% e kompanive ballafaqohen me ndërprerje të energjisë elektrike të paparalajmëruara gjatë dites, duke ndikuar në aktivitetin e tyre.
- ✓ Mungesa e investimeve/projekteve kapitale nga institucionet: Rreth 35% e kompanive shprehen se mungesa e investimeve/projekteve kapitale nga institucionet qendrore dhe lokale ka ndikuar në aktivitetin e tyre biznesor.
- ✓ Të tjera: Përveç këtyre, kompanitë shprehen për barrierat e tjera si gjobat e paparalajmëruara nga ATK, ligjet dhe rregulloret e miratuara nga institucionet pa konsultim me bizneset.

Këto informacione ofrojnë një përkujdesje të rëndësishme për nevojat dhe sfidat aktuale të bizneseve në vend. Gjithashtu, ato janë të rëndësishme për qeverinë dhe politikën e saj, duke mundësuar zhvillimin e masave dhe politikave që përmirësojnë klimën e biznesit dhe inkurajojnë zhvillimin ekonomik.



Figura 22: Barrierat e të bërit biznes sipas të gjithë sektorëve



5. Sfidat e ndërmarrjeve lidhur me rekrutimin e fuqisë punëtore

5.1. Situata aktuale e bashkëpunimit në mes kompanive dhe institucioneve arsimore


Analiza tregon se shumica e kompanive përballen me një sfidë të shprehur në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar. Në përgjithësi, 53% e kompanive shprehin se e kanë të pamundur gjetjen e personelit të kualifikuar, duke karakterizuar këtë aspekt si një detyrë shumë të vështirë. Ndërkaq, 37% e kompanive e vlerësojnë këtë situatë si të vështirë, ndërsa vetëm 10% e tyre raportojnë se e kanë pak të vështirë gjetjen e punëtorëve të kualifikuar.

Ky rezultat thekson një nevojë të rritur për staf të kualifikuar në tregun e punës dhe shpreh një mungesë potenciale të aftësive specifike që kompanitë e anketuara po kërkojnë. Sfidat e identifikuar në gjetjen e personelit të kualifikuar mund të ketë ndikim në funksionimin e



përditshëm të bizneseve dhe, gjithashtu, të krijojë nevojën për strategji dhe përpjekje të shtuara në rekrutim dhe trajnim të punëtorëve të kualifikuar.

Figura 23: Vështirësit në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar




Rezultatet e hulumtimit tregojnë se bashkëpunimi midis kompanive dhe shkollave profesionale apo institucioneve arsimore në Kosovë është ende në nivele relativisht të ulëta. Vetëm 9% e kompanive të deklaruara kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi (MB) me ndonjë shkollë profesionale ose institucion arsimor. Ky shifër ilustron se ende ka një hapësirë të madhe për zhvillim dhe rritje të këtij bashkëpunimi në kuadër të iniciativave të Mesimit në Vendin e Punes (MVP) dhe Sistemit Dual të Arsimit në Kosovë.

Nënkuptohet se ndërmarrjet në Kosovë mund të përmirësojnë lidhjet e tyre me institucionet arsimore, duke ndihmuar në përgatitjen dhe zhvillimin e një fuqitë punëtore të kualifikuar që plotësojnë nevojat e tyre specifike. Këtë mund ta shohim si një mundësi për të përmirësuar përshtatshmërinë e aftësive të të rinjve me kërkesat e tregut të punës, duke krijuar një përputhje më të mirë midis shkollave profesionale dhe nevojave të kompanive.



Figura 24: Bashkëpunimi (Memorandum Bashkëpunimi) kompani me shkollë profesionale/institucion arsimor




Në kontekstin e tregut të punës në Kosovë, identifikimi i profileve deficitare tregon nevojën për një përshtatje më të mirë të aftësive të punëkërkuësve me kërkesat e tregut të punës. Disa nga profesionet që shfaqen si më të munguara dhe të nevojshme janë:

- ✓ Hulumtues Tregu
- ✓ Agjent Distributor i Shitjes
- ✓ Furnizues për Stoqet e Mallrave
- ✓ Saldues
- ✓ Dizajner i Enterierit
- ✓ Teknolog i Ushqimit
- ✓ Operues dhe Serviser i Makinave Prodhuese
- ✓ Arkitekt
- ✓ Strukturues Metali
- ✓ Përpunues i Drurit
- ✓ Agjent i Marketingut
- ✓ Programer
- ✓ Dizajner i Tekstilit
- ✓ Kuzhinier
- ✓ Kontabilist
- ✓ Elektriko/Hidro/Termo Instalues
- ✓ Automekanik
- ✓ Të tjera (Frizer, Llamarinopunues, Ndërtimtar, Përpunues Mishi/Kasap, Përpunës Xhami, Shofer)





Figura 25: Profilet deficitare në tregun e punës




5.2. Sfidat e tregut të punës në vitin e ardhshëm

Bizneset shprehin një shqetësim të theksuar në lidhje me largimin e punëtorëve pas liberalizimit të vizave, duke shfaqur një ndjenjë të përgjithshme të pasigurisë dhe sfidave të mundshme në tregun e punës. Sipas rezultateve të anketës, 67% e bizneseve e vlerësojnë këtë situatë si shumë shqetësuese, ndërsa 27% e shohin si një çështje e shqetësueshme. Vetëm një pjesë e vogël, 4%, e cilëson si pak e shqetësueshme, ndërsa vetëm 2% nuk shprehin asnjë shqetësim.

Ky nivel i lartë i shqetësimit është i shpjegueshëm në kontekstin e liberalizimit të vizave, ku pritet një lëvizje më e lirë e qytetarëve nga Kosova drejt vendeve të tjera. Në këtë situatë, kompanitë shqetësohen për humbjen e punëtorëve të kualifikuar dhe të aftësive të tyre, duke lënë një boshllëk në tregun vendor të punës dhe duke kontribuar në sfidat e rekrutimit dhe mbajtjes së punëtorëve.

Ky shqetësim mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanive, pasi ata mund të hasin vështirësi në ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre njerëzore. Për të adresuar këtë çështje, mund të jenë të nevojshme masa dhe politika specifike nga ana e qeverisë dhe biznesit, përfshirë perkrahja e sistemit dual për profilet e lartecakura, bursave për profilet deficitare, subvencionimi i kompanive që bashkëpunojnë dhe kontribuojnë në dhe bashkëpunojnë ngushtë me institucionet arsimore për të siguruar një rrjedhë të qëndrueshme të punëtorëve të kualifikuar në tregun vendor, përmes sistemit dual apo mësimin në vendin e punës.

Figura 26: Shqetësimi i bizneseve nga largimi i punëtorëve pas 1 Janarit 2023 me liberalizimin e vizave




Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e kompanive vendore kanë pak eksperiencë të mëparshme ose aktualisht në punësimin e punëtorëve të huaj. Përkatesisht, 88% e kompanive nuk kanë pasur përvojë në punësimin e punëtorëve të huaj. Ndërkohë, një pjesë relativisht e vogël, 8%, kanë përvojë në punësimin e punëtorëve të huaj në një shifër nga 1 deri në 10 punëtorë të huaj, ndërsa vetëm 4% kanë përvojë mbi 10 punëtorë të huaj.

Ky rezultat tregon se, në përgjithësi, kompanitë vendore nuk kanë shfaqur në përmasa të larta për përdorimin e fuqisë punëtore nga jashtë vendit. Pavarësisht kësaj, kompanitë të cilat kanë



rekrutuar punëtorë nga vendet e huaja janë nga sektori i ndërtimit, sektori i prodhimit, si: përpunimi i metalit, mobileve, sektori i PVC dhe përpunimit të ushqimit.

Figura 27: Përvoja me punësimin e punëtorëve të huaj nga kompanitë vendore




Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e kompanive janë të kujdesshme dhe kritike kur është fjala për rritjen e numrit të punëtorëve të huaj në periudhën e ardhshme. Në total, 88% e kompanive kanë thënë se nuk parashikojnë të rekrutojnë punëtorë të huaj në gjashtë muajt e ardhshëm.

Megjithatë, një përqindje e vogël e kompanive prej 8% parashikojnë të punësojnë një numër prej 1 deri në 10 punëtorë të huaj, ndërsa 4% e tyre janë të gatshme të përfshijnë më shumë se 10 punëtorë të huaj në ekipin e tyre.

Ky përqindje relativisht e vogël tregon se kompanitë janë të kujdesshme në strategjitë e tyre të punësimit dhe vlerësojnë kujdesisht nevojat dhe kapacitetet e tyre aktuale për forca punëtore. Nëse situata ndryshon ose nevojat për shkathtësi specifike rriten, ato mund të ndryshojnë qëndrimin e tyre në të ardhmen.



Figura 27: Punësimi ndonjëherë ose aktualisht i punëtorëve të huaj nga kompanitë vendore



Disa nga kanalet që do të përdoren për të rekrutuar janë si vijon:

Agjencitë private të rekrutimit (60%): Shumica dëshirojnë të përdorin shërbimet e agjencive private të rekrutimit për të identifikuar dhe siguruar punëtorë të huaj.


Agjencia publike e punësimit (14%): Një pjesë më e vogël e kompanive planifikojnë të përdorin shërbimet e agjencive publike të punësimit për rekrutimin e punëtorëve të huaj.

Tjetër (26%): Një pjesë e konsiderueshme e kompanive kanë përcaktuar modalitete të tjera për rekrutimin e punëtorëve të huaj, duke përfshirë mundësitë e ndryshme të përmirësuara për tregun e punës, bashkëpunimin direkt me shkolla profesionale apo institucione trajnimi, ose përdorimin e kanaleve të tjera të specializuara.

Kjo shpjegon diversitetin e modaliteteve të përdorura nga kompanitë për të rekrutuar punëtorë nga vendet e huaja.



Figura 28: Forma e rekrutimit të punëtorëve të huaj nga kompanitë vendore



Planifikimi i rekrutimit të punëtorëve të huaj është bërë për pozicione të caktuara. Bazuar në rezultatet e hulumtimit, kompanitë kanë shprehur se nevoja për fuqi punëtore të huaj është në pozicionet e ndryshme me nivelet e kualifikimit të ndryshme.

Me kualifikim të ulët (18%): Pjesa më e vogël e pritshme për rekrutim të punëtorëve të huaj është në pozicione me kualifikim të ulët. Kjo mund të përfshijë punëtorë me shkathtësi dhe përvojë në fusha të caktuara.

Me kualifikim të mesëm (73%): Shumica e madhe e pritshme është për rekrutim të punëtorëve të huaj me kualifikim të mesëm. Ky interes mund të lidhet me nevojat e kompanive për shkathtësi të specializuara dhe njohuri të larta në fusha të caktuara të operacioneve.


Me kualifikim të lartë (7%): Në raste të veçanta, ka një interes të caktuar për rekrutim të punëtorëve të huaj me kualifikim të lartë. Kjo mund të përfshijë profesionistë dhe specialistë që mund të sjellin njohuri të thella dhe ekspertizë në disiplina specifike.

Menaxheriale (2%): Një pjesë më e vogël e kompanive shpreh nevojën për forca punëtore të huaja në pozicione menaxheriale. Kjo tregon që disa kompani mund të jenë të interesuara për të



përdorur shkathtësitë udhëhënëse dhe menaxheriale të punëtorëve të huaj për të drejtuar dhe koordinuar operacionet e tyre.

Figura 29: Pozicionet për të cilat do të rekrutinin punëtorë të huaj kompanitë vendore



Kompanitë, vlerësojnë disa faktorë kyç për punësimin e punëtorëve migrantë. Analiza e hulumtimit dhe vlerësimeve të kompanive tregon se faktorët kryesorë që merren parasysh janë:


- ✓ Mungesa e aftësive: Në kërkim të forca punëtore të kualifikuar dhe me aftësi të veçanta, kompanitë vlerësojnë punëtorët migrantë për kontributin e tyre në mbushjen e zbrazëtirave të aftësive specifike dhe të nevojave të tyre.
- ✓ Efektiviteti i kostos: Për shkak të një konkurrence të lartë dhe presioneve të tregut, kompanitë vlerësojnë efektivitetin e kostos që punëtorët migrantë mund të sjellin. Në disa raste, ata mund të ofrojnë një alternativë më ekonomike krahasuar me punëtorët vendas.
- ✓ Diversiteti dhe përfshirja: Përfshirja e punëtorëve migrantë sjell një aspekt të rëndësishëm të diversitetit në ambientin e punës. Kompanitë shohin këtë si një pasuri,



- ✓ pasi diversiteti mund të sjellë ide të reja, perspektiva të ndryshme, dhe një mjedis më të pasur kulturorisht.
- ✓ Aftësi gjuhësore: Një aftësi e mirë gjuhësore e punëtorëve migrantë mund të jetë një faktor kyç për komunikim të suksesshëm në ambientin e punës. Aftësia për të komunikuar efektivisht mund të ndikojë pozitivisht në performancën dhe bashkëpunimin në ekip.
- ✓ Zgjerimet e tregut: Në rastet kur kompanitë planifikojnë zgjerime të biznesit dhe hapjen e tregjeve të reja, ata vlerësojnë rolin e punëtorëve migrantë në lehtësimin e këtij procesi dhe në përshtatjen ndaj kërkesave të reja tregtare.
- ✓ Punë sezonale: Në sektorët që përfshijnë punë sezonale, punëtorët migrantë janë shpesh vlerësuar për fleksibilitetin dhe gatishmërinë e tyre për të përfshirë në periudhat e punës intensive të caktuara.

Përfshirja e këtyre faktorëve në procesin e vendimmarrjes për punësimin e punëtorëve migrantë përmirëson strategjitë e rekrutimit dhe krijon një model më të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për nevojat e kompanive.

Figura 30: Faktoret që vlerësohen në punësimin e punëtorëve migrantë





6. Deklarata e Përgjithshme dhe konkluzione

Ky studim i monitorimit të bizneseve, i cili ka përfshirë 500 kompani nga sektorët e prodhimit, ndërtimit, shërbimeve, tregtisë me pakicë dhe tregtisë me shumicë në Kosovë, është një analizë thelbësore e situatës ekonomike dhe sfidave me të cilat ballafaqohen kompanitë vendase. Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte vlerësimi i situatës dhe klimes ekonomike aktuale të kompanive, si dhe identifikimi i synimeve dhe pritjeve të tyre për tremujorin e katërt të vitit 2023 dhe për periudhën e ardhshme.

Rezultatet kryesore të nxjerra nga ky studim tregojnë se përgjithësisht gjendja e biznesit në Kosovë vlerësohet si jo e favorshme nga kompanitë e përfshira në hulumtim. Megjithatë, është vërejtur një rënie pritshmërive për situatën e tremujorit të katërt të vitit 2023, një aspekt që shënon një ndryshim të përceptuar në kushtet ekonomike.

Në këtë kontekst, barriera kryesore që shfaqet është mungesa e porosive, e identifikuar nga rreth 53% e kompanive. Përveç kësaj, mungesa e personelit të kualifikuar, kapacitetet teknike të vogla, dhe sfidat në financime si mungesa e cash flow-it dhe vështirësitë në marrjen e kredive, kanë dalë si sfida themelore që ndikojnë në performancën e kompanive.

Në anën tjetër, këto sfida të identifikuara mund të trajtohen si një mundësi për të ndërmarrë masa korigjuese dhe për të krijuar politika mbështetëse për kompanitë vendase. Bashkë me këtë, është e rëndësishme që institucionet vendase dhe qeveria të marrin masa konkrete për adresimin e këtyre sfidave, përmes ofrimit të mjeteve financiare, përmirësimit të infrastrukturës, dhe krijimit të kushteve të favorshme për zhvillimin e bizneseve.

Në përfundim, kjo analizë siguron një panoramë të qartë të kushteve ekonomike dhe sfidave të kompanive në Kosovë, duke ofruar një bazë të rëndësishme për diskutimet dhe veprimet e ardhshme në drejtim të avancimit të klimës së biznesit dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike.



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik





ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Rr. Nëna Terezë, Nr.20
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org